

FJALA E DEPUTETES GERTA DURAKU

E HENE 2 TETOR 2023

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Dua ta nis fjalën time duke falënderuar dhe duke përshëndetur të gjithë qytetarët e Kukësit për mbështetjen që i dhanë kandidatit të Partisë Socialiste, zotit Albert Halilaj, në zgjedhjet e 24 shtatorit. Kjo tregon se vetëm Partia Socialiste është forca që mund ta çojë në një tjetër nivel qeverisjen vendore, njëllon si atë qendrore. (Debat pa mikrofon) Fitorja në Kukës është një përgjegjësi më shumë për t'i çuar para punët në këtë bashki, që ka potenciale të jashtëzakonshme. Në fakt, përtej fitores politike, dua të them se më të fituar janë kuksianët dhe Kukësi, sepse zgjodhën një djalë intelektual, të thjeshtë, që jeton përditë me problemet dhe hallet e tyre. Dua t'u them të gjithë atyre që nuk votuan për kandidatin tonë se ne do të punojmë njësoj për të gjitha komunitetet dhe njësitë, sepse ne jemi të vetëdijshëm se privilegji që na është dhënë për të drejtuar, është një përgjegjësi për t'u shërbyer të gjithëve njëllon, pa asnjë dallim. E nisa fjalën në kontekstin e këtyre zgjedhjeve sepse vota masive për Partinë Socialiste, rrjedhimisht, kërkon një vëmendje më të madhe dhe duhet të përkthehet në më shumë investime për të gjithë qarkun e Kukësit. Nuk dua të përsëris sa shumë kemi bërë në këta 10 vjet për qarkun, por dua të flas për ato që kam diskutuar me qytetarët, pra për problemet që kërkojnë vëmendje. Ndaj edhe Partia Socialiste ndryshon nga çdo kundërshtar i saj, pasi ne i dëgjojmë qytetarët dhe shqetësimet e tyre ndiqen hap pas hapi, duke bërë çmos për t'u dhënë zgjidhje. Papunësia, edhe pse është ulur për shkak të investimeve dhe ecurisë së mirë të turizmit, mbetet përsëri e lartë. Lufta jonë është që të punojmë më shumë me të gjithë aktorët dhe faktorët për të ulur papunësinë dhe për t'u dhënë mundësi qytetarëve që t'i zhvillojnë bizneset e tyre në ato fshatra dhe zona me bukuri natyrore të papërsëritshme. Janë organizuar shumë takime të përbashkëta me përfaqësues të qeverisë, pushtetit lokal, shoqërisë civile apo me biznesin, me objekt zhvillimin ekonomik të qarkut dhe besoj se një pjesë e rëndësishme e kërkesave do të mund të pasqyrohen në buxhetin e vitit 2024.

Qarku i Kukësit i ka sytë te zbatimi i reformave ekonomike dhe te prioritetet që ka qeveria për këtë zonë. Unë kërkoj me ngulm nga Ministria e Bujqësisë të ketë një vëmendje më të madhe dhe të ketë më shumë projekte për këtë zonë. Nuk nevojiten shumë para, por çdo investim, sado i vogël qoftë, ka një ndikim shumë të madh në jetën e këtij komuniteti. Të gjithë e dimë se këto zona kanë jetuar tradicionalisht me blegtori, shumë pak me bujqësi apo turizëm, disa zona kanë pataten, disa gështenjën, bimët medicinale dhe minierën e kromit. Pra, kjo është pasqyra ekonomike e këtij qarku. Në mbështetje të asaj që thashë më lart, dua të dal te një tjetër problematikë që kërkon zgjidhje, regjistrimi i tokave. Regjistrimi i tokave është jetik për këto zona dhe patjetër që duhet të jetë në vëmendje të qeverisë sonë, si një ndër zonat prioritare ku duhet të nisë puna menjëherë. Në këtë mënyrë ne u japim mundësi atyre banorëve që të përfitojnë nga subvencionet, grantet dhe fondet e Bashkimit Europian për zhvillimin e turizmit rural. Mundësitë janë që qarku ynë të mos qëndrojë në vend. Një gjë pozitive sot është trefishimi, krahasuar me vitin e kaluar, i numrit të turistëve që vizitojnë Kukësin, Tropojën dhe Hasin. Ky vit ka qenë me të vërtetë një vit i suksesshëm në turizëm dhe ka ndikuar pozitivisht në të ardhurat e qytetarëve që merren me biznesin e hotelerisë, me produktet ushqimore dhe blegtorale. Ne kemi një zonë me bukuri të rralla natyrore, këtu kam parasysh Tropojën, Kukësin dhe Hasin, por mungesa e infrastrukturës rrugore në shumë zona i bën ato të vështira për t'u aksesuar.

Të gjitha këto i them sepse i kemi shkelur vetë dhe kemi parë turistë të shumtë që kishin mungesë informacioni ose pyesnin si mund të shkonin në x vend, që kishin parë në internet. Sigurisht që këto janë në planet e bashkisë, por pa ndihmën e pazëvendësueshme të qeverisë do të jetë e vështirë të zbatohen plotësisht. Investimet e vazhdueshme në infrastrukturë janë domosdoshmëri për të gjithë ata që nuk i kanë lëshuar ato troje dhe jetojnë atje, por edhe për ata që janë të gatshëm të kthehen për të investuar, por i pengon mungesa e infrastrukturës, edhe pse është bërë shumë punë. Kukësi e ka vlerësuar punën që kemi bërë deri më sot dhe për këtë arsye na e ka dhënë dhe na e ka ridhënë besimin për ta qeverisur. Ky besim i atyre njerëzve ndaj nesh kërkon të shlyhet me projekte të reja që do ta çojnë në një tjetër nivel standardin e jetesës dhe ekonominë lokale. Jam e bindur që ne do ta respektojmë besimin e tyre me punë dhe vetëm me punë të mira.

Faleminderit!